



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2019, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve, si ndihmë për zonat e dëmtuara nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 € dhe merren nga kodi buxhetor 1.5.1 (16306) kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Administratës.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ia ndan Republikës së Shqipërisë për sanimin e dëmeve të shkaktuara në zonat e dëmtuara nga tërmeti.

**IV.**

Mjete e cekura sipas pikës II të këtij vendimi, do të derdhen në xhirollogarinë e hapur të Republikës së Shqipërisë për këtë fatkeqësi natyrore.

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**VI.**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-422/01-0291194/19, më 27.11.2019**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Agim Kuleta**

